



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM ORIENTUES
PËR MATURËN SHTETËRORE**

(Provim i detyrur)

**LËNDA:
GJUHË ANGLEZE**

Koordinatorë: Erifili Hashorva

Viti shkollor: 2013 -2014

**TIRANË
JANAR, 2014**

1. UDHËZUES I PËRGJITHSHËM PËR PROGRAMIN E PROVIMIT KOMBËTAR TË MATURËS SHETËRËRE PËR LËNDËN E GJUHËS ANGLEZE DHE PËR PËRDORIMIN E TIJ NGA MËSUESIT

Ky program orientues mbështetet në standardet e arritjes së mësimin të gjuhës angleze dhe bazuar në udhëzimin e datës 26/12/2013 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit ‘Për Zhvillimin e Provimeve të Maturës Shtetërore’ ku gjuha e huaj është provim i detyruar dhe niveli i njohurive i përket nivelit **A2**, sipas dokumentit evropian “Kudri i Përbashkët Evropian i referencave për Gjuhët”.

Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në programet e gjuhës angleze, të cilat përcaktojnë njohuritë dhe shprehjet e domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale.

Programi orientues për përgatitjen dhe realizimin e provimit të Maturës Shtetërore për gjuhën angleze si provim i detyruar, është realizuar si sintezë e njohurive dhe shprehjet të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë, si në aspektin tematik ashtu edhe në aspektin gjuhësor (gramatikor, leksikor) dhe funksional.

Ky program duhet të nxisë inspirim dhe sfidë për të gjithë nxënësit dhe t’i përgatisë ata për të ardhmen. Programi Orientues është ndërtuar duke pasur parasysh nevojat e nxënësve, zhvillimet e tyre personale duke u dhënë mundësi për sukses në atë çka i pret.

Synimet e Programit

Ky program synon:

- Të ndihmojë nxënësin maturant në përgatitjen e tij për provimin e gjuhës angleze si provim i detyruar.
- Të ndihmojë mësuesin e lëndës në punën e tij për zbatimin e programit dhe për t’u dhënë orientimet e duhura nxënësve.

- Vlerësimin e njëkohshëm të 2 aftësive kryesore (nga katër aftësi që ka gjuha e huaj) dhe dy konceptet bazë, që janë: *'të lexuarit dhe të kuptuarit'* dhe *'të shprehurit me shkrim'*.
- Të japë orientime për specialistët që merren me hartimin e testeve të Maturës Shtetërore për gjuhën angleze si provim i detyruar.

Udhëzime praktike mbi përdorimin e programit

Për përdorimin e këtij programi mësuesi duhet të ketë parasysh specifikën e gjuhës së huaj, ku nxënësi në provim do të përballet me situata të reja ose me pjesë të reja leximi por tematika, gramatika dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato që ka studiuar ndër vite.

Kur flitet për tematikën kryesore në program nxënësit duhet që të kenë njohuri për temat që janë të përfshira në program (food, health and safety, travel time, environmental issues, sports and entertainment, modern living, etc.)

Përsa i përket gramatikës, mësuesi duhet t'i përgatisë nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi aspektet kryesore gramatikore (passive voice, conditionals, reported speech, verb tenses, adverbs and adjectives comparisons, connectors, etc.) duke dalë nga konteksti i mësimave ku këto probleme trajtohen. Mësuesi duhet t'i vërë theksin anës praktike të zgjidhjes së ushtrimeve, duke i trajtuar këto ushtrime në forma të ndryshme, herë me tipe ushtrimesh me alternativa, e herë tipe ushtrimesh të hapura, ku më të spikaturat janë *sentence transformation*, *error correction*, etj.

Funksionet gjuhësore duhet të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës por duke ruajtur formatet dhe shprehjet që jepen në tekstet mësimore. Nxënësi duhet të jetë i përgatitur kryesisht për këto funksione gjuhësore:

- expressing their interests
- talking about different fields of interests
- recommending places
- suggestions (proposals, comments) on simple issues
- Likes and dislikes
- Inviting

- Asking and answering simple personal questions
- Exchanging courtesies.

Përsa i përket të shkruarit mësuesi duhet të ushtrojë nxënësit e tij që të dinë të organizojnë forma të ndryshme kompozimi jo letrar (me tema të thjeshta). Ata duhet të përgatiten që të ndërtojnë paragrafë të saktë nga ana strukturore dhe leksikore. Gjithashtu mësuesi duhet të përgatisë nxënësit që të dinë të përmbledhin me shkrim një përvojë personale duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tij në një tekst koherent. Nxënësi duhet të jetë i përgatitur të shkruajë një email ose letër formale ose jo formale; të zbatojë rregullat e shkrimit të një e-mail-i, një letre formale dhe joformale.

2. Aftësitë dhe njohuritë që duhet të zotërojë nxënësi maturant për të qenë i përgatitur për Provimin e Maturës në gjuhën angleze si provim i detyruar.

Nxënësi duhet të demonstrojë **aftësitë dhe njohuritë** e tij për çka më poshtë vijon:

2.1 Të Lexuarit dhe të Kuptuarit (Reading Comprehension)

Vlerësimi i këtij komponenti do të bëhet mbi bazën e një teksti të panjohur mbi të cilin do të ndërtohen pyetje që do të testojnë aftësinë e nxënësit për të kuptuar një pjesë letrare ose jo letrare, dhe për të gjykuar mbi të.

Nxënësi duhet të jetë në gjendje të lexojë dhe të kuptojë në mënyrë të përgjithshme informacionin e dhënë në pjesën e leximit, të mbledhë informacionet që i kërkohen rreth tekstit apo të japë një vlerësimim të shprehur me gjuhë të thjeshtë mbi atë çka i kërkohet.

Më poshtë po rradhësim disa aspekte të leximit:

- Marrja e informacionit të duhur nga teksti i dhënë.
- Reflektimi mbi përmbajtjen e një fragmenti dhe nxjerrja e informacionit të duhur prej tij.
- Thellim në kuptimin e një fraze dhe gjetja e sinonimit të saj.
- Formimi i një kuptimi të përgjithshëm dhe nxjerrja e moralit të pjesës shprehur në gjuhë të thjeshtë.
- Paraqitja e elementëve që justifikojnë përgjigjen e dhënë.
- Plotësimi i ushtrimeve leksikore rreth tekstit.

- Gjetja e fjalëve referuese.

2.2 Të Shprehurit me Shkrim (Writing)

Në provimin e maturës nxënësi duhet të jetë në gjendje të prodhojë tekste të shkruara mbi një gamë jo shumë të gjerë temash duke i lidhur elementët në mënyrë koherente, duhet të jetë në gjendje të bëjë përshkrime jo shumë të hollësishme mbi tema të njohura, të tregojë me shkrim përvojat e tij duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tij, të përshkruajë një ngjarje, një udhëtim real duke përdorur gjuhë të thjeshtë dhe të pangarkuar me detaje, të shkruajë një letër personale apo zyrtare, një e-mail formal dhe joformal duke respektuar formatet e mësuara gjatë viteve që nxënësi ka studiuar këtë gjuhë, etj.

Për vlerësimin e kësaj aftësie, nxënësi duhet të paraqesë një produkt të shkruar prej **100-120** fjalësh. Nxënësi vlerësohet për përmbajtjen, leksikun, korrektësinë gramatikore, strukturën e rrjedhën logjike.

Të shprehurit me shkrim përfshin:

- të shprehurit me shkrim në formën e një përshkrimi, letre, etj për një gamë të gjerë temash të njohura e komplekse që janë trajtuar ndër vite në nivelin **A2**,
- një produkt të shkruar saktë nga ana gramatikore dhe të strukturuar mirë: short letters (formal and non-formal ones), e-mails (formal and non-formal ones), applications, -summaries of short texts, etc.,
- shprehjen e pikëpamjeve në formë të thjeshtë dhe të qartë,
- përdorimin e një repertori të thjeshtë leksikor,
- komente të shkurtëra me shkrim për probleme të ndryshme (short stories, descriptions of people, places, events and objects).
- të ruajë rendin e mendimeve në të gjithë pjesën e shkruar.

2.3 Përdorimi i Gjuhës (Use of English)

Në këtë program njohuritë kryesore që nxënësi ka marrë mbi përdorimin e gjuhës ndër vite, janë të dhëna përmes ushtrimeve, temave, bashkëbisedimeve që trajtojnë njësi të ndryshme gramatikore ose leksikore, pra në mënyrë esenciale fjalori dhe gramatika e mësuar.

Tipet e ushtrimeve të rekomanduara për fushat e sipërpërmendura:

Të lexuarit dhe të Kuptuarit (Reading Comprehension)

- Pyetje mbi përmbajtjen e tekstit.
- Ushtrime me përzgjedhje fjalësh ose frazash.
- Plotësimi i vendeve bosh me informacionin e duhur (Sentence or phrase completion).
- Ushtrime me përgjigje po/jo.
- Ushtrime me e vërtetë/e rreme (True or False).
- Ushtrime me disa alternativa (Multiple Choice, përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 ose 5 alternativat e dhëna).
- Ushtrime ku i kërkohet marrja dhe përzgjedhja e informacionit të duhur nga teksti i dhënë.
- Ushtrime ku i kërkohet reflektimi mbi përmbajtjen e një fragmenti dhe nxjerrja e informacionit të duhur prej tij.
- Vendosja e paragrafëve sipas rendit të duhur në renditjen e ngjarjeve (Arrangement of paragraphs).
- Ushtrime ku i kërkohet paraqitja e elementëve provues që mbështesin idenë e dhënë nga vetë nxënësi.
- Ushtrime ku i kërkohet thellim në kuptimin e një fraze dhe gjetja e sinonimit të saj.

Përdorimi i Gjuhës (Use of English; Grammar and Vocabulary)

- Ushtrime me zëvendësim, zëvendësimi i një fjale me të ngjashmen e saj.
- Ushtrime transformimi, shprehja e një fjalie me një strukturë tjetër, por duke ruajtur kuptimin e fjalisë.
- Ushtrime me shumë zgjedhje/alternativa (Multiple Choice).
- Ushtrime me plotësime vendesh bosh, vendosja e fjalës së duhur.
- Ushtrime me ndërtim fjalish.
- Ushtrime me gjetje dhe korrigjime gabimesh.
- Matching (përshtatje).

Të Shkruarit (Writing)

- Shkrimi i një *e-mail*-i, ku i tregohet një miku rreth një eksperience që ka lënë mbresa.
- Shkrimi i një letre formale ose jo formale.
- Aplikime ose rekomandime për një punë *part-time* (me kohë të pjesshme)
- Shprehja e mendimit rreth një çështjeje të caktuar.

Struktura e Provimit në përqindje

Aspektet Gjuhësore që do të vlerësohen	Përqindja
Reading and Comprehension Të Kuptuarit e një teksti të shkruar (letrar ose joletrar)	40%
Use of English (Grammar and Vocabulary) Përdorimi i Gjuhës (gramatika dhe leksiku)	40%
Writing Të Shkruarit (ese' ose krijim, një letër, kërkesë, përshkrim, artikull, përmbledhje, etj.)	20%

3. Përmbajtja e Programit

Fushat tematike dhe leksiku

Përmbajtja tematike

Tematika e mëposhtme, e parashikuar për provimin e maturës, do të përfshijë temat bazë (sipas kurrikulës) dhe nëntema të marra nga kurrikula dhe tekstet.

Duke pasur parasysh se shkollat e zhvillojnë mësimin me libra të ndryshëm, tematika është formuluar në mënyrë përgjithësuese dhe jo sipas titujve të mësimëve, me të cilët

nxënësit janë familjarizuar, por sigurisht përfshin të gjitha njohuritë e përvetësuara në shkollë përmes këtyre teksteve:

Tematika (Topics)

- **Every day life** (Eating, cooking customs in Albania; around the world; sports; personal preferences; free time; hobbies, interests).
- **The World around us** (Traveling, famous places around the world; money and shopping; environmental issues etc.).
- **The World of learning and Work** (school issues, work interviews, studies, school friendship, etc.).
- **Personal and social life** (Health problems, injuries and illnesses; clothes; celebrations in Albania and other countries; physical characteristics of the people, etc.)
- **The World of communication** (TV programs, reality shows, films, radio programs, letters, e-mails and postcards).

Leksiku

Në bazë të temës, përzgjidhet gjuha dhe aktet gjuhësore si edhe strukturat gramatikore që mundësojnë realizimin e komunikimit rreth një teme të caktuar. Nxënësi duhet të zotërojë një repertor leksikor të mjaftueshëm për t'u shprehur thjeshtë me shkrim dhe me gojë.

Aktet dhe funksionet komunikative

Sugjerohen aktet dhe funksionet e mëposhtme, të cilët shërbejnë si mënyrë orientuese për hartimin e testit dhe vlerësimin e nxënësve. Aktet dhe funksionet komunikative japin shprehitë kryesore që nxënësi ka fituar ndër vite.

- Expressing interests or preferences on something.
- Expressing likes and dislikes.
- Expressing obligation, permission and prohibition.
- Giving personal information or advice to someone.

- Expressing opinions; agreeing, or disagreeing.
- Suggesting, and taking a decision.
- Asking about/recommending places.
- Expressing possibility, probability, certainty.

Elementët dhe strukturat gramatikore

Për një komunikim të saktë nga ana gramatikore, si me gojë ashtu edhe me shkrim, sugjerohet të punohet në mënyrë të përqëndruar mbi strukturat dhe çështjet gramatikore më të rëndësishme të trajtuara .

- **Verb Tenses:**
 - Present Tenses, Past Tenses, Future Tenses, Perfect Tenses, Continuous Tenses.
- **Gerund and Infinitive Verb Patterns:**
 - (She hates washing up. The teacher asked me to revise the topic once again).
- **Reported Speech** (positive, interrogative and imperative forms).
- **Active and Passive Voice:** (present, past, future, perfect).
- **Conditionals:** (0, 1st, 2nd, verb tenses and their combinations in conditional sentences).
- **Modal Verbs** (may, might, should, have to, must, could).
- **Adjectives** (comparison degrees, and different ways of comparisons).
- **Prepositions, and Phrasal Verbs.**
- **Adverbs**
- **Connectors** (above all, such as, then, therefore, whereas, instead, furthermore, however, even so, etc.)

Note to students:

You must think about the language you want to use. It is not enough just to memorize lists of expressions or to memorise the texts from your coursebook. You need to be able to adapt your knowledge to the situation. Language is a creative process.

If you have worked steadily and sensibly during the course then the 'Matura Exam' should come as a surprise to you.